



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU-DEJES

PAKETA FISKALE

VITI 2025



BASHKIA VAU DEJËS
Paketa Fiskale 2025

Permbajtja:

A Mbi Bashkinë Vau-dejes

A.1 Procesi i Hartimit të Paketës fiskale

A.2 Çfarë prezanton paketa fiskale?

A.3 Kuadri ligjor dhe nënligjor

B. Paketa Fiskale

Kapitulli I: Taksat vendore

I.1 Tatim mbi te ardhurat personale

I.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (ndertesa, toka trualli)

I.3. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

I.4. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

I.5 Taksa e tabelës

I.6 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

I.7. Taksa e fjetjes në hotel

I.8. Taksa e Rentes minerare

I.9. Taksa e akteve te pulles

Kapitulli II: Tarifat vendore

II.1 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

II.2 Tarifa e ndriçimit

II.3 Tarifa e gjelbrimit

II.4 Tarifa e mirembajtjes se infrastruktures se ujitje kullimit

II.4 Tarifa hapësirës publike

II.5 Tarifa licensim tregtim karburante

II.6 Tarifa e Zhvillimit Territorit

II.7 Tarife parkimi

II.8 Tarife leshim licensa+certifikata transporti

II.9 Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

II.10 Tarifa të tjera vendore.

Kapitulli III Gjoba

III. 1. Gjoba për mosshlyerje në afat të detyrimit.

III.2. Gjoba nga kontrollet dhe inspektimet tatimore.

III.3. Te tjera gjoba.

Kapitulli IV Të ardhura jo tatimore

IV.1. Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë .

IV.2. Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime.

IV.3. Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve.

IV.4.Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara.

IV.5. Të ardhura nga sponsorizimet



BASHKIA VAU DEJËS
Paketa Fiskale 2025

A. MBI BASHKINË VAU DEJËS

Bashkia Vau Dejës ndodhet në qarkun e Shkodrës, kufizohet në Veri dhe Perendim me Bashkinë Shkodër, ka një sipërfaqe prej 468 km², përbëhet nga 1 qytet dhe 48 fshatra, dhe me një popullësi prej 52 123 banorësh dhe 14.619 familje. Në territorin e Bashkisë Vau Dejës ushtrojnë aktivitetin e tyre disa ndërmarrje shtetërore, biznese të ndryshme të sektorit privat, institucione arsimore, si kopshte, shkolla e konvikte dhe ka një potencial shumë të favorshëm për të zhvilluar një turizem të qëndrueshëm.

Sipas Ligjit Nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njesive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia Vau Dejës përbëhet nga 6 njesi administrative të cilët janë: Njesia Administrative Vau Dejës, Bushat, Vig – Mnelë, Hajmel, Temal dhe Shllak. Bashkia Vau Dejës ka nën administrimin e saj qytetin Vau Dejës dhe 48 fshatra.

Tabela 1. Ndarja sipas qyteteve, fshatrave dhe Njesive Administrative të Bashkisë Vau Dejës.

Tabele nr. 1

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë Administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas census 2011	Popullsia sipas Regjistrat Civil	Sipërfaqja km ²
Shkodër	Qyteti Vau Dejës	Vau Dejës	Qytetet; Vau Dejës, Fshatrat; Mjede, Deje, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Spathar, Gomsiqe, Karme.	30,438	52 123	468 km ²
		Bushat	Fshatrat; Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat I Ri, Mali I Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten			
		Vig – Mnele	Fshatrat; Mnelë e Madhe, Mneleë e Vogël, Vig			
		Hajmel	Fshatrat; Hajmel, Dheu I Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë			
		Temal	Fshatrat; Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Killogjen, Malagji-Kajvall, Toplanë, Sermë, Gushte			
		Shllak	Fshatrat; Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushaj, Benë, Kroni I Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj			



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

A.1 Proçesi i hartimit të paketes fiskale

Tashmë paketa fiskale është e domosdoshme të integrohet dhe të aplikohet në të gjithë territorin e Bashkisë Vau Dejës.

Për hartimin e paketës fiskale 2025 janë angazhuar drejtues dhe specialiste në Bashkinë Vau Dejës si:

- Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar
- Drejtoria e Sherbimeve Publike, Bujqesise, Mrojtjes civile dhe Konsumatorit
- Drejtoria e Planifikimit Territorit dhe Investimeve Publike
- Drejtoria e Pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes Mjedisit
- Drejtoria Juridike, Integritit, prokurimeve dhe Aseteve Publike.
- Drejtoria e Nd.Ekonomike Arsimit Rinise dhe Sporteve
- Drejtoria Mbrojtjes, Perfshirjes dhe Strehimit Social
- Sektori i MZSH
- Sektori Bujqesise, Ujitjes dhe Kullimit
- Sektori Aseteve
- Administratoret e Njesive Administrative

Hapat për hartimin e paketes fiskale janë si më poshtë:

- Ngritja e grupit të punës për hartimin e paketes fiskale të integruar
- Përcaktimi i baze ligjore dhe prioriteteve strategjike të zhvillimit
- Konsultimi i propozimeve të paketes fiskale me banoret e çdo njesie administrative dhe me gjithë grupet e interesit si subjektet private etj.
- Hartimi i draft paketes fiskale 2025 dhe miratimi nga Këshilli i Bashkisë.
- Publikimi i Paketes fiskale

Konsultimi me qytetarë dhe grupet e interesit

Në hartimin e paketes fiskale 2025 të Bashkisë Vau Dejës, eshte ndjekur procedura si me poshte:

30 dite perpara, eshte publikuar dhe jane zhvilluar degjesa publike ne njesite administrative, dhe konkretisht ne daten 22.12.2024, ne ora 10.30, ne Nj.A. Vau-dejes, me date 23.12.2024, ora 10.30 ne Nj.A. Bushat, dhe date 24.12.2024, ora 10.30, ne Nj.A. Hajmel, duke paraqitur taksat dhe tarifat, si dhe ndryshimet e bera, per vitin 2025. Ne keto degjesa ka pase diskutime, propozime nga grupet e interesit dhe ne pergjithsi, per taksa apo tarifa vendore, nga ana e tyre dhe pastaj miratimi ne keshillin bashkiak.

A.2 Çfarë prezanton paketa fiskale 2025



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

Prezanton propozimet për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojme për periudhën në vazhdim, duke qënë në linjë dhe në zbatim me prioritetet e strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Vau Dejës dhe Planit të Zhvillimit të Territorit.

Propozimet konsistojnë në përmirësime teknike dhe proceduriale për përgatitjen e një pakete fiskale të integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë.

Në menyrë të përmbledhur kjo pakete fiskale synon:

- a) Hartimin e një pakete fiskale të integruar
- b) Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat njësia vendore duhet të arketojë të ardhura.
- c) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësiive për çdo takse dhe tarife, pjesë të kësaj pakete fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent.
- d) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave dhe tarifave. Çdo takse dhe tarife do të detajohet duke patur në konsideratë elementët:
 - Taksim të drejtë
 - Tarifim mbështetje në kosto
 - Klasifikim i biznesit në llojin e subjektit, xhiron e subjektit, sipërfaqen e subjektit etj.
 - Qartësimi dhe përcaktimi i taksave dhe tarifave që aplikohen në kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj.

Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimin dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha taksat, përcaktimin e bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji;

- e) Rikategorizimi dhe detajimi i taksave
- f) Aplikimi i incentivave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë siç parashikon ligji.

A.3 Kuadri ligjor dhe nenligjor

Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, është Ligji bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në aspektin e vendosjes së taksave, mbledhjen dhe administrimin e tyre.



BASHKIA VAU DEJËS
Paketa Fiskale 2025

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe Ligjin Nr. 9975, datë 28.07.2008, ”Për taksat kombëtare” i ndryshuar, ne Ligjin Nr. 68/2017, date 27.04.2017 “Per financat vendore”, në të ardhurat vendore përfshihen:

- Taksa e pasurisë
- Taksa e ndikimit të infrastrukturës nga ndërtimet e reja
- Taksa e tabelës/reklamat
- Taksa për automjetet/mjetet e përdorura
- Taksa për transferimin e pasurisë së patundshme
- Taksa e fjetjes në hotel
- Tarifa dhe shërbime të ndryshme

B. PAKETA FISKALE 2025

KAPITULLI. I TAKSAT VENDORE

Në këtë kapitull trajtohen taksat vendore të cilat gjejnë zbatim në Bashkinë Vau Dejës. Për secilën taksë, paketa fiskale përcakton bazën e taksueshme, kategoritë dhe nënkategoritë, mënyrën e pagesës, kështët e pagimit, koha e kryrjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturën përgjegjëse dhe rregullat në administrim dhe agjentet tatimorë.

I.1 Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Ne zbatim të ligjit 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”, neni 25, pika 2, germa (ç), dhe ligjit Nr. 29/2023, date 30.3.2023 “Per tatimin mbi të ardhurat”, udhezimin e përgjithshëm Nr. 26, date 8.9.2023 “Per tatimin mbi të ardhurat”

Baza e taksës: Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritet mbi të ardhurat e individëve nga apunesimi, biznesi, investimet.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore përfitojnë si taksë të ndarë, 2 (dy) për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale, deri në momentin e njoftimit të metodologjisë perkatese për shpërndarjen e tatimit mbi të ardhurat personale sipas juridiksionit të punonjesve ku mbledhet tatimi.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Drejtoritë rajonale të tatimeve janë përgjegjëse për arkëtimin. Ministria e Financave shpërndan të ardhurën takuese për Bashkinë Vau dejes.

I.2. TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME

1. Bashkia Vau dejes si njësi e vetqeverisjes vendore, për taksën mbi pasurine e paluajtshme, zbaton parashikimet ligjore të Ligjit Nr. 9632, date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe parashikimet nenligjore të VKM nr. 132, date 7.3.2018 “Per metodologjinë për



BASHKIA VAU DEJËS
Paketa Fiskale 2025

percaktimin e vleres se taksueshme te pasurise se paluajtshme “ndertesa” e bazes se takses per kategori specifike, natyren dhe prioritetin e informacioni dhe te dhenave per percaktimin e bazes se takses, si dhe te kriterëve dhe rregullave per vleresimin alternativ te detyrimit te takses, i ndryshuar.

2. Bashkia Vau dejes, per efekt te percaktimit te bazes se taksueshme te pasurise se paluajtshme “ndertese”, ndjek radhen e vleresimit dhe parashikimet perkatese te percaktuara ne piken 1, te nenit 2 te VKM nr. 132/2018, te ndryshuar

3. Paragrafet e pikes I.2 “Taksa mbi pasurine e paluajtshme”,

a. Perkufizimet e termave jane si me poshte:

“Pasuri e paluajtshme”, jane trualli, toka bujqesore dhe ndertesat mbi dhe nen toke, sipas percaktimit te Kodit Civil dhe legjislacionit per regjistrimin e pasurive te paluajtshme”,

“Kadastra Fiskale” është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

“Niveli tregues i taksës” janë nivelet e taksave të parashikuara sipas ligjit 9632/2006, i ndryshuar, në anekset perkatese, si dhe percaktimet perkatese te pasurise se paluajtshme”ndertese” sipas nenit 1 te VKM nr.132/2018, i ndryshuar.

b. Percaktimi dhe llojet:

-Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

-Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- a) taksa mbi ndërtesat;
- b) taksa mbi tokën bujqësore.
- c) taksa mbi truallin.

Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit 9632/2006, i ndryshuar, zyrat rajonale të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme u ofrojnë bashkive dhe të dhënat e regjistrimit elektronik të pasurisë.

c. Rregulla te perbashketa te takses se pasurise se paluajtshme

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.

Kategoritë minimale të bazës së taksës sipas klasifikimit dhe nivelet respektive të taksës mbi tokën bujqësore dhe mbi truallin (jo hapësirë publike), jepen përkatësisht, në anekset 1 dhe 2, te Ligjit Nr. 9632, date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,

d. Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit 9632/2006, i ndryshuar, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive dhe për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, bashkia vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

e. Pronat që shtrihen në territorin e më shumë se një njësie të qeverisjes vendore

Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie, pavarësisht nga vendbanimit i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e ligjit nr. 9632/2006 i ndryshuar

4. Pika I.2.1. “Taksa mbi ndërtesat”

a. **Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit.** Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.

b. **Këshilli bashkiak vendos** për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:

- personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kritereve të përcaktuara në nivel kombëtar;
- taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
 - pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
 - ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
 - banesat sociale në pronësi të bashkive;
 - pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

- ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
- ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

c. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen

- Individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në ligj përcaktohen ndryshe.
- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar
- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

d. Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 132/2018, i ndryshuar.

Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

e.Shkalla e taksës mbi ndërtesat e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës është si me poshtë:

- 0.05% për ndërtesat që përdoren, shfrytëzohen për banim.
- 0.2% për ndërtesat që përdoret, shfrytëzohen për veprimtari ekonomike
- 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur të përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

f.Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore

1.Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:

- mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;
- përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);
- mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën; korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.;



BASHKIA VAU DEJËS
Paketa Fiskale 2025

- shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

2. Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave ligjore, mund të mbledhet nëpërmjet agjentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave. Bashkia Vau dejes, nuk operon me agjent ne mbledhjen e taksave.

3. Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin “Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.”

g. Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit 9632/2006, i ndryshuar, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive dhe për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, bashkia vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

h. Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie, pavarësisht nga vendbanimi i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e ligjit 9632/2006 I ndryshuar.

i. Perkufizimi termave: “ndertese”-Objekti/objektet e ndertuara mbi/nen sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose shumë njësi pronësore, e cila është objekt i takses mbi ndertesen sipas përcaktimit të dhënë në ligj.

j. “Cmim vlerësues”, njësia matëse e vlerës për m² të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky cmim mund të jetë cmimi i tregut, ose cmimi i vlerësuar i përcaktuar me këtë metodologjinë sipas VKM nr. 132, datë 7.3.2018, i ndryshuar.



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

k. Vlera e pasurisë “ndertese” referuar verifikimeve në terren. Njesite e vetqeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e kuadrit ligjor në fuqi, kryejnë korrektime në regjistrin e bazës së të dhënave. Korrektimet kryhen bazuar në verifikimet periodike në terren për sipërfaqen e ndertesës/njesisë pronësore.

i. “Sipërfaqja e prezumuar”, Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndertesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe si më poshtë:

- a) 100 m² sipërfaqe për njesi pronësore për ndertesat për banim.
- b) 70m² sipërfaqe për njesi pronësore për ndertesat për banim të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 të ndryshuar.

m.Nënndarja zonale/nënzonale brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së takses, brenda kufijve +/-30%, për njesite administrative që i janë bashkuar Bashkisë qendër, për ndertesat që shërbejnë për banim.

n.Vlera e pasurisë së paluajtshme për ndertesat e paperfunduara në shkëlqje të afatit të lehtë së ndertimit: Për ndertesat e pajisura me leje ndertimit por që nuk kanë arritur të përfundojnë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndertimi, përcaktimi I bazës së taksueshme bazohet mbi koston e parashikuar të ndertimit, sipas lejes së ndertimit të miratuar nga njesia Bashkia. Në këtë rast vlera e bazës së takses së ndertesës llogaritet për të gjithë ndertesën kur është një njesi e vetme dhe e destinuar për një qëllim të vetëm përdorimi pavarësisht fazës në të cilën gjendet ndertesa e paperfunduar.

o.Llogaritja e shumës së takses së ndertesës/njesisë pronësore, Njesite e vetëqeverisjes vendore, duke përdorur të dhënat e mbledhura për ndertesës/njesinë pasurore, përcaktohet baza e takses dhe llogaritin shumën e takses vjetore të ndertesës për të paguar nga çdo taksapagues. Baza e llogaritjes së takses së ndertesës është vlera e ndertesës/njesisë pronësore përcaktuar në një nga metodat e parashikuara në VKM nr. 132, datë 7.3.2018 të ndryshuar. Për efekt të llogaritjes së takses për ndertesën/njesinë pronësore, baza e takses shumëzohet me shkallën e takses sipas kategorive të përcaktuara në VKM 132, datë 7.3.2018, të ndryshuar.

- 0.05% për ndertesat/njesite pronësore që përdoren/ shfrytëzohen për banim
- 0.2% për ndertesën/njesinë pronësore që përdoret/shfrytëzohet për veprimtari ekonomike
- 30% e shkallës së takses perkatese për të gjithë sipërfaqen ndertimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndertimit dhe nuk ka arritur të përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndertimi.

p.Procedura e mbledhjes së informacionit nga verifikimi në terren të bëhet sipas metodologjisë së përcaktuar në piken 6 (6.1-6.9) të VKM 132/2018 të ndryshuar

q. Verifikimi periodik në terren i pasurisë “ndertese”, bëhet sipas metodologjisë së përcaktuar në piken 7 të VKM Nr. 132/2018, të ndryshuar

r.Verifikimi i të dhënave nga ana e nepunësit përgjegjës në bashki, të bëhet sipas pikës 8 të nenit 2 të VKM nr. 132/2018, të ndryshuar



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

s. Korigjimi i te dhenave ne lidhje me llogaritjen e takses ne rastet e saktesimit te informacionit per siperfaqen, te behet sipas pikes 9 te VKM nr. 132/2018, te ndryshuar.

t. Ankimimi administrative dhe ankimi gjyqesore, te behet sipas pikes 10, te nenit 2 te VKM nr.132/2018 te ndryshuar

u. Ndryshimi i perdorimit te ndertesave nga sa eshte rregjistruar te behet sipas pikes 12, te nenit 2 te VKM nr. 132/2018 te ndryshuar

v. Nenkategorite specifike te ndertesave jane te percaktuar sipas nenit 3 te VKM nr.132/2018, te ndryshuar.

w.Natyra dhe Burimet e informacionit te merren nga:

- Te dhena nga vetdeklarimet
- Te dhena nga ASHK
- Te dhena ne zyra urbanistikes per lejet e ndertimit
- Te dhena nga verifikimi ne terren
- Te dhena nga Rregjistri Gjendjes Civile
- Te dhena nga OSHE, Ujesjellesi, etj
- Te dhena nga Agjensia e Trajtimet Pronave per pesuri te trajtuara me vendime KKKP

x/y. Cmimet mesatare referuese jane te percaktuara ne Aneksin 1 dhe 2 te VKM Nr. 132/2018 te ndryshuar.

- Nendarja zonale, kategorite, shkalla e takses dhe cmimet reference, per m2 siperfaqe ndertimit, per ndertesat/njesite pronesore, qe sherbejne per BANIM dhe AMBJENTE JO BANIMI, ne Bashkine Vau Dejes, do jete si ne tabelen e meposhtme:

Tabela 2

Nendarjet Zonale dhe Kategorite			
A. Ndërtesa qe sherbejne per BANIM. Sipas Aneksi 1.	Shkalla e takses % -30%	Cmimi references ne m2 sipas Aneksi 1	Vlera ne lek/m²/vit Miratuar per vitin 2025
A.1 Nendarje zonale 1 (Nj.A Vau-Dejes qender, Bushat, Hajmel)	0.05	24300	12
A.2 Nendarje zonale 2 (Nj.A.Vig-Mnel, Shllak, Temal)	(0.05 -30%) = 0.035%	24300	8.5
A.1.1 Garazhet e mbyllura per nendarjen zonale 1 (Nj.A. Vau dejes,qender, Bushat dhe Hajmel) (cmimit refereces Aneksi 1)	0.05	24300	12
A.1.2 Bodrumet per nendarjen zonale 1 (Nj.A. Vau dejes,qender, Bushat dhe Hajmel) (cmimit refereces Aneksi 1)	0.05	24300	12



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

A.2.1 Garazhet e mbyllura per nendarjen zonale 2 (Nj.A. Vig-Mnele, Shllak, Temal) 70% e cmimit referees Aneksi 1)	(0.05 -30%) =0.035%	(24300*70%) 17010	5.96
A.2.2 Bodrumet per nendarjen zonale 1 (Nj.A. Nj.A. Vig-Mnele, Shllak, Temal) 70% e cmimit referees Aneksi 1	(0.05 -30%) =0.035%	(24300*70%) 17010	5.96
A.3. Ndertesa te tjera te ngjashme (70% e cmimit referues Aneksi 1)	0.05	(24300*70%) 17010	8.5
A.4 Ndertesa privatizuara sipas ligjit “Per privatizimin e banesave te nendarjes zonale 1(Nj.A. Vau dejes qender, Bushat dhe Hajmel)” (70% e cmimit referues Aneksi 1)vetem ne rastin e shitjes se pare.	0.05	(24300*70%) 17010	8.5
A.5 Ndertesa privatizuara sipas ligjit “Per privatizimin e banesave te nendarjes zonale 2 (Nj.A. Vig-Mnele, Shllak, Temal)” (70% e cmimit referues Aneksi 1)vetem ne rastin e shitjes se pare.	(0.05 -30%) =0.035%	(24300*70%) 17010	5.96
B. NDERTESA DHE AMBJENTE JO BANIMI sipas Aneksi 2	Shkalla e takses ne %	Cmimi references ne m2, sipas Aneksi 2	Vlera ne lek/m²/vit miratuar
B.1. Njesi per veprimtari ekonomike tregtimi dhe sherbimi (1.5here me I larte se cmimit banesave Aneksi 1) ketu perfshihen edhe njesite tregtare ku njehkosisht realizohen edhe procese te perziera prodhimi, tregtimi apo sherbime me pakice.	0.2%	(24300*1.5) 36450	72.9
B.2. Per parkim te mbuluar dhe bodrumet (70% e cmimit te baneses Aneksi 1)	0.2%	(24300*70%) 17010	34.02
B.3. Per ambjente parkim te hapur, pishine e hapur, ambjente sportive te hapur te tilla si fusha futbollit, minifutbollit basket bolli, volejbolli, tenisi, golfi, pista per gara te ndryshme sportive te atletikes, motorike, garave me kuaj, e te tjera te ngjashme me to, porte, aeroporte te cdo kategorie per te gjitha sip. e shtrire qe ato zene.	0.2%	(24300*30%) 7290	14.58



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

(30% e cmimit te baneses Aneksi 1)			
B.4. Per veprimtari industriale , te tilla si prodhim, perpunim apo magazinim te lendeve te para, te gjysmeprodukteve apo te produkteve te gatshme industriale, si fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike te produkteve ushqimore(perjashtuar ato te tregtimit e sherbimit) si dhe objekte te tjera te ngjashme me to. Ketu perfshihen dhe ndertesa qe sherbejne per veprimtari arsimore jopublike te cdo niveli, si dhe ambjentet sportive te mbyllura dhe pishinat e mbyllura. (50% e cmimit te baneses Aneksi 1)	0.2%	(24300*50%) 12150	24.3
B.5.Per veprimtari bujqesore dhe blektorale , apo veprimtari mbeshtetese si grumbullim, magazinim dhe ruajtje te produkteve bujqesore dhe blegtorale. (30% e cmimit te baneses) Aneksi 1	0.2%	(24300*30%) 7290	14.58
B.6.Njesi ndertimore per ndertimet e reja rregjistruar sipas lejes se perdorimit ne ASHK, pas hyrjen ne fuqi te ketij Vendimi do te indeksohet me koeficientin 0.2(zero pike dy) here me i larte se cmimi i siperfaqes se apartamentit te banimit sipas listes se percaktuar ne Aneksin 1 , per 5 vitet e para pas rregjistrimit ter lejes se perdorimit ne ASHK	0.2%	(24300*0.2= 4860+24300) 29160	58.32

C. Ndertesa te paperfunduara	Shkalla e takses se ndertesave per banim 0.05%	Shkalla e takses se ndertesave per veprimtari ekonomike 02%
<i>C.1-Ndertesa per qellime banimi</i>	30% * 0.05% * koston e ndertimit	
<i>C.2-Ndertesa per veprimtari ekonomike</i>		30%*0.2%* koston e ndertimit

Perjashtohen nga taksa mbi ndertesat:

- Pronat e shtetit dhe te njesive te qeverisjes vendore, qe perdoren per qellime jofitimpruese.*
- Pasurite ne pronesite e shtetit, te kaluara me Vendim te Keshillit Ministrave nen administrimin e shoqerive publike shteterore.*
- Ndertesat e banimit qe shfrytezohen nga qiramarresi me qera te paliberalizuara.*
- Banesat sociale ne pronesi te bashkive.*



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

- e) Pasurite e paluajtshme-ndertesat prone e subjekteve juridike ose fizik qe ne baze te marreveshjeve me Bashkite perdoren nga keto te fundit si banesa sociale.
- f) Ndertesat qe perdoren nga komunitetet fetare, ne funksion te veprimtarise se tyre.
- g) Strukturat akomoduese "Hotel/Resort me 4 dhe 5 yje, statur special, sipas percaktimit ne legjislacionin e fushes se turizmit dhe qe jane mbajtes te nje marke tregtare te rregjistruar dhe njohur nderkombetarisht "brand name".
- h) Ndertesat e banimit te deklaruar si vendbanim nga kryefamiljaret qe perfitojne vetem pension pleqerie/ pension social, kur familja perbehet vetem nga pensioniste, ose dhe me persona ne ngarkim te tyre, qe jane te paafte per pune.
- i) Ndertesat e banimit te kryefamiljareve qe trajtohen me ndihme ekonomike.
- j) Ndertesat kulturore, nen mbrojtje te perkohshme ose te perhershme, per kohen ne te cilen deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit ne fuqi per monumentet e kulture dhe/osetrashegimine kulturore", te cilat perdoren vetem per qellime jofitimprures.
- k) Personat, te cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivel kombëtar;
- l) Taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind

Menyra e pageses:

Detyrimi per taksen e nderteses eshte vjetor dhe llogaritet nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, per te gjithë kryefamiljaret sipas rregjistrimit themeltar te gjendjes civile te ardhur nga DPGJC Tirane, per familjaret, ndersa per bizneset tek rregjistrimi i biznesve nga QKB. Afati i pageses do te jete brenda dates 30.06.2025, per bizneset, ndersa per familjaret do jete deri me date 31.12.2025,. vendi i pageses do te jete, prane cdo banke te nivelit dyte apo prane zyrave postare.

Struktura perkatese per vjeljen e takses:

Struktura perkatese per vjeljen e takses se nderteses per te gjitha kategorite, eshte sektori i taksave dhe tarifave vendore, i cili do pergatise njoftimet me afat brenda 3-mujorit pare te vitit 2025, per bizneset dhe gjate gjithë vitit per familjaret dhe dergimi do behet nepermjet postes shqiptare. Mund te zbatohen edhe menyra te tjera te elektronike si e-mail, etj. apo, edhe sipas kerkeses se taksapaguesit.

5. Pika I.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore.

- a. **Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen** të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- taksa mbi ndërtesat;
- **taksa mbi tokën bujqësore.**
- taksa mbi truallin.



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat rajonale të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme u ofrojnë bashkive dhe të dhënat e regjistrimit elektronik të pasurisë.

b/c. Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.

d. Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme

- Kategoritë minimale të bazës së taksës sipas klasifikimit dhe nivelet respektive të taksës mbi tokën bujqësore dhe mbi truallin (jo hapësirë publike), jepen përkatësisht, në anekset 1 dhe 2, që i bashkëngjiten këtij ligji 9632/2006, i ndryshuar

- Këshilli bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në aneksin 1, në kufijtë plus-minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

-Kur për një kategori minimale të bazës së taksës, këshilli bashkiak miraton nënkategori, ai, detyrimisht, përcakton edhe nivelin e taksës për secilën nënkategori. Niveli i taksës për çdo nënkategori është brenda kufijve të përcaktuar në ligjin 9632/2006, i ndryshuar.

e. Këshilli bashkiak vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:

- personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivel kombëtar;

- taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.

f. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka. Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

- Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 1 të këtij ligji.

- Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

-Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

g. Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi ligjit 9632/2006, I ndryshuar, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive dhe për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, bashkia vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit (aneksi 2 i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, i ndryshuar)

Kategorite:

Niveli tregues i taksës mbi tokën bujqësore sipas kategorizimeve, te jete si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 3

Kategoritë mesatare e tokës bujqësore	Njësia	Niveli sipas ligjit (lek/ha/vit)	Niveli i taksës për vitin 2025
I	lek/ha/vit	4,200	4,200
II	lek/ha/vit	3,500	3,500
III	lek/ha/vit	2,800	2,800
IV	lek/ha/vit	2,300	2,300
V	lek/ha/vit	1,900	1,900
VI	lek/ha/vit	1,600	1,600
VII – X	lek/ha/vit	1,400	1,400

Përfshihen nga taksa mbi tokën bujqësore;

- personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivel kombëtar;

- taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

- Tokat bujqësore që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes. Fermeri duhet të sjellë faturen dhe certifikaten e cilesise se materialit të mbjelljes së ketyre kulturave.

Mënyra e pagesës:

Njoftimi për detyrimin e kesaj takse behet me nje kest te vetem nga sektori i taksave gjate gjithë vitit 2025, e ndersa afati i pageses te jete brenda dates 31.12.2025. Vendi i pagesës së taksës së tokës bujqësore është Posta Shqiptare sh.a dega Hajmel dhe Bushat ose pranë çdo banke të nivelit të dytë për llogari të bashkisë.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :

Ngarkohet Sektori i Bujqësisë, për vlerësimin e kategorisë së tokës, si dhe vlerën e takses në leke/ha, për çdo fshat, pasi një kryefamiljar disponon tokë bujqësore në disa kategori, brenda fshatit, po ashtu të kryejnë saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë.

Gjithashtu Sektori i Bujqësisë, ngarkohet për të bërë azhurnimet nga ndryshimet e herepashershme, të sipërfaqes dhe të ja përcjellë këtë informacion me shkrim, sektorit taksave dhe tarifave vendore, për llogaritjen e detyrimit.

Struktura e ngarkuar për llogaritjen e taksës mbi tokën bujqësore, është Sektori i taksave dhe tarifave vendore, pranë Bashkisë, pas informacionit të sjellë nga sektori i bujqësisë.

6. Pika I.2.3 “Taksa mbi truallin”

- Taksës mbi pasurinë e paluajtshme** i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

-Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- taksa mbi ndërtesat;

- taksa mbi tokën bujqësore.

- **taksa mbi truallin.**

- Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit 9632/2006, I ndryshuar, zyrat rajonale të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme u ofrojnë bashkive dhe të dhënat e regjistrimit elektronik të pasurisë.

- Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit.** Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

c. Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme 2.1

- Kategoritë minimale të bazës së taksës sipas klasifikimit dhe nivelet respektive të taksës mbi tokën bujqësore dhe mbi truallin (jo hapësirë publike), jepen përkatësisht, në anekset 1 dhe 2, që i bashkëngjiten këtij ligjit 9632/2006, I ndryshuar.
- Këshilli bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në aneksin 1, në kufijtë plus-minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.
- Kur për një kategori minimale të bazës së taksës, këshilli bashkiak miraton nënkategori, ai, detyrimisht, përcakton edhe nivelin e taksës për secilën nënkategori. Niveli i taksës për çdo nënkategori është brenda kufijve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni 21, të ligjit 9632/2006, i ndryshuar

d. Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme

Këshilli bashkiak vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:

- personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kritereve të përcaktuara në nivel kombëtar;
- taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.

e. Taksa mbi truallin

- Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Kategoritë minimale të truallit jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligjit 9632/2006, I ndryshuar. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.
- Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2, të këtij ligjit 9632/2006, I ndryshuar
- Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

f. Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit 9632/2006, I ndryshuar, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive dhe për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, bashkia vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

Niveli tregues i taksës mbi truallin sipas kategorizimeve, te jete si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4

Nr.	Emërtimi	Niveli i taksës
1.	Taksë truallit për qëllime banimi nga individët	0,14 lek/m ² /vit
2.	Taksë truallit për qëllime biznesi	12 ek/m ² /vit

Perjashtohen nga taksa e truallit:

- personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivel kombëtar
- taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.

Menyra e pageses:

Njoftimi për detyrimin behet nga sektori i taksave me një kështë të vetem, për të gjithë familjarët gjatë gjithë vitit 2025, dhe afati i pageses te jete data 31.12.2025, ndersa për bizneset njoftimi te behet brenda 3-mujorit te pare te vitit 2025, pagesa te jete brenda dates 30.06.2025.

Vendi i pagesës së taksës së truallit është, Posta Shqiptare sh.a dega Hajmel dhe Bushat ose pranë çdo bankë të nivelit të dytë për llogari të Bashkisë Vau Dejës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e taksës së truallit është Sektori i taksave dhe tarifave vendore.

I.3. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURE NGA NDËRTIMET E REJA

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9632, date 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", Neni 27, ndryshuar në Ligjin nr. 142/2015, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632 date 30.10.2006, te ndryshuar Ligjin Nr.41/2018, date 9.7.2018, i ndryshuar.

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri, që kërkohet të kryhet sipas preventivit,



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

ose vlera në lek e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri, Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

“Vlere investimi” është vlera e përcaktuar sipas çmimit të shitblerjes së EKB dhe VKM Nr. 132, datë 07.03.2008, i ndryshuar, anekset 1 dhe 2, sipas kategorise së ndërtesave ”banim”, apo “tregti e shërbime”

Vlera në lek për metër katror e çmimit të shitjes së njërive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerre me akt të Këshillit të Ministrave.

Këshilli bashkiak miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës

Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.”.

Kategoritë:

Niveli tregues i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Niveli i taksës, sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë:

Tabela nr. 5

KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË	Sipas ligjit në % të çmimit të shit- blerjes për m²	Niveli taksës për vitin 2025
Për ndërtime të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi e shërbimi , të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi.	4% - 8% çmimit të shit- blerjes	4.0% çmimit të shit-blerjes
Ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër. (Ndertime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit industrisë , bujqësisë të ndërtimeve individuale, për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individët apo me sipërmarres, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike)	1% - 3% e vlerës investimit	1.0% vlerës investimit
Për projektet e infrastrukturës shtetërore, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, porte aeroporte, tunele, digave,, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për	0.1% vlerës investimit	0.1% vlerës investimit



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

keto projekte, kjo takse eshte 01% vl.investimit, por jo me pak se kostoja e rehabilitimit te infrastruktures se demtuar, kur kjo kosto nuk eshte perfshire ne preventivin e investimit.		
Te gjitha ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	0.5% vleres investimit	0.5% vleres investimit
Ndertesat qe destinohen per qellime banimi ne zonat malore, ku perfshihen (NJ.A. Temal, Shllak, Vig-Mnele)qe miratohen nga KB.	0-3% vleres investimit	3% vleres investimit

Detyrimi dhe kështet e pagimit: Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorive të mesiperme.

Perjashtohen nga taksa e ndikimit ne infrastrukture:

- *Investimet e kryera per ndertimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pese yje, status special", sipas percaktimit ne legjislacionin e fushes se turizmit dhe qe jane mbartes te nje marke tregtare te rregjistruar dhe njohur nderkombetarisht "brand name".*
- *Investimet e subjekteve , te cilat zhvillojne veprimtari pritesa te certifikuar si "agroturizem", sipas legjislacionin ne fushen e turizmit.*
- *Objektet e Kultit te bashkesive fetare, sipas ligjit Nr. 10140, date 15.5.2009.*
- *Investimet per rindertimin, riparimin apo restaurimin e ndertesave te demtuara si pasoje e fatkeqsive natyrore.*

Menyra e pagese:

Pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë bëhet me një kësht të vetëm në momentin e dhënies së lejes së ndërtimit. Vendi i pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë është Posta Shqiptare sh.a, ose pranë cdo banke të nivelit të dytë për llogari të bashkisë Vau Dejës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës të ndikimit në infrastrukturë është Sektori i taksave dhe tarifave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Territorit dhe Investimeve Publike.

I.4. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSIË PËR PASURITË E PALUJTESHME

Baza ligjore: Ligjin nr 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 28.Ligji Nr. 68/2017, date 27.04.2017,"Per financat vendore", neni 25.

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtësat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të



BASHKIA VAU DEJËS
Paketa Fiskale 2025

paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre, niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2% .

- Ngarkohet për mbledhjen e kesaj takse Agjensia Shtetërore e Kadastres, të cilat në rolin e agentit të taksave përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit të bashkisë, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës, dhe(97%) e merr Bashkia Vau-Dejes.
- Ngarkohet Sektori i taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë të bëjë rakordimet dhe planifikimin e të ardhurave me ASHK Shkoder.

Kategoritë

Niveli tregues i taksës mbi kalimin e pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kategorizimi i taksës së kalimit e pronësisë për pasuritë e paluajtshme për të gjitha **ndërtesat**, paraqitet në tabelën që vijon:

Tabela nr. 6

Tipi I ndërtesës	Lek/m²
Ndërtesa banimi	100
Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	300
Ndërtesa të tjera	200

Lehtësi tatimore

Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- a. Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore
- b. personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake në mbështetje të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar
- c. subjektet, që dhurojnë pasuri të paluajtshme, kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
 - i) institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
 - ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agentit të taksave.

I.5. TAKSA E TABELËS DHE E REKLAMËS

Baza Ligjore: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Kreu V, nenet 32, 32/1.



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi. Vendorsja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve. Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Menaxhimit Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

Detyrimi i taksës përlllogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj.

Vendorsja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve.

Kategoritë:

Kategoritë dhe niveli i taksës jepet si në tabelën e mëposhtëme:

Tabela nr. 7

Klasa	Lloji i tabelës	Njesia matese	Niveli Taksës 2025
I.	Takse table per qellime identifikimi, te trupezuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe qe nuk perdoret per te reklamuar veprimtarin e te treteve(ku shenohet emridhe/ose aktiviteti i biznesit)		
a.	Deri ne 2 m2	leke/m2 /vit	0
b.	Mbi 2m2 deri ne 10 m2 - e thjeshte (pa ndricim) - me ndricim te thjeshte - elektronike	leke/m2 /vit	7.000 11.500 15.000
c.	Mbi 10m2 deri 20 m2 - e thjeshte (pa ndricim) - me ndricim te thjeshte - elektronike	leke/m2 /vit	5.950 9.775 12.750
ç	Mbi 20m2 deri ne 40m2 - e thjeshte (pa ndricim) - me ndricim te thjeshte - elektronike	leke/m2 /vit	3.850 6.325 8.250
d.	Mbi 40 m2 - e thjeshte (pa ndricim) - me ndricim te thjeshte - elektronike	leke/m2 /vit	2.800 4.600 6.000
II	Tabelë për qëllime identifikimi jashte territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit ne formen dhe permasat e tabelave per		



BASHKIA VAU DEJËS
Paketa Fiskale 2025

	orientim.		
	- Tabela identifikuese	<i>leke/m²</i> <i>/vit</i>	120
III.	Tabela per qellime reklamimi e levizshme e palevizshme deri ne tavanin maksimal 35 m2 - e thjeshte(me/pa ndricim) - elektronike	<i>leke/m²</i> <i>/vit</i>	13.500 27.000
IV.	Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura,panaiere, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj. <i>-te te gjitha llojeve dhe permasave</i>	<i>lekë/m²/di</i> <i>të</i>	1 000

- Ne llogaritjen e takses per tabelat me te medha se 10 m2, 20m2, 40m2 shume e takses se llogaritur per siperfaqen deri ne 10m2, 20 m2 40 m2 do ti shtohet shuma e takses se llogaritur per diferencon e siperfaqes mbi 10 m2, 20 m2, 40 m2 te shumezuar me tarifen perkatese te takses ne table.
- Per subjektet taksapaguese qe vendosin me shume se nje table identifikuese, vetem njera nga dy tabelat identifikuese do te konsiderohet si e tille, kurse tabela e tjeter do te konsiderohet si reklame.
- Çdo table reklamimi qe kalon siperfaqen 35 m2 do te konsiderohet sikur eshte 35 m2 dhe shuma e takses llogaritet dhe paguhet vetem per kete siperfaqe, pavaresisht siperfaqes se saj ne m2.
- Ne kategorin e reklames do te kuptojme cdo publicitet, forme promovimi qe sherben per te njoftuar, terhequr vemendjen ose joshur bleresit, te vendosur ne pamje joballore, ne tarraca, lozhe,ballkone,, ne pjese te rruge, shtylla etj qe kane permbajtje me qellime reklamimi per vete oese te trete.

Njoftim detyrimi behete me nje kest te vetem brenda 3-mujorit pare te vitit 2025, ndersa afati i pageses eshte data 30.06.2025.

I.6. TAKSA E MJETEVE TË PERDORUARA

Baza ligjore: Ligji 68/2017, date 27.04.2017 “Per financat vendore”, neni 25, ne Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 783, datë 10.11.2011,” Për Procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”;

Baza e taksës: është lloji I mjetit të transportit rrugor.

Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore, (25%) të të ardhurave vjetore nga kjo takse i kalon përkatësisht Bashkisë Vau dejes në llogarinë e degës së thesarit.

I.7. TAKSA VENDORE MBI VEPRIMTARINE E SHERBIMIT HOTELIER

Baza ligjore: Ligji Nr.9632, dt.30.10.2006,“Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 26

Baza e takses se fjetjes ne hotel, eshte numri i neteve te qendruar ne hotel per person .Jane subjekt i takses te gjithë hotelet, motelet, pensionet, shtepite e pritjes, turizem familjar dhe cdo objekt tjeter qe perdoret per kete ushtrim veprimtarie. Niveli i takses se fjetjes ne hotel eshte 105 per nate qendrimi per hotelert 4-5 yje dhe 35 leke per nate qendrimi per Bujtine, fjetine, motel dhe cdo njesi tjeter akomoduese sipas percaktimeve te ligjit per turizimin .



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

Detyrimi per taksen llogaritet si shumzim i nivelit te takses se vendosur nga bashkia, per nate qendrimi, me numrin e neteve te qendrimit ne hotel. Derdhja e te ardhurave per kete takse nga hoteli ne favor te Bashkise ne juridiksionin ne te cilen ndodhet vendodhja e tij,

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogaritë bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Kategoritë dhe niveli i taksës jepet si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.8

Nr.	Emertimi	Niveli tregues
I.7.1	Takse fjetje në hotel për hotelet 4-5 yje	105 leke/nate qendrimi
I.7.2.	Takse fjetje në hotel për bujtine, fjetine, motel dhe çdo njesi tjetër akomoduese sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin.	35 leke/nete qendrimi

Detyrimi derdhet për bashkinë brenda datës 5 të muajit pasardhës nga subjekti përkatës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e taksës së fjetjes në hotel është Sektori i të Ardhurave pranë Bashkisë Vau Dejës, ne bashkepunim me sektorin e kontrollit ne terren.

I.8. ARDHURA NGA TAKSA E RENTES MINERALE

Baza e taksës:

Ligji nr. 10304 datë 15.07.2010, "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet tëpagojë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

Struktura e mbledhjes e kësaj takse jane Deget e doganave në rrethe, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë në llogarinë e degës së Thesarit.

Ngarkohet Sektori i taksave dhe tarifave vendore, pranë Bashkisë të bëjë rakordimet dhe planifikimin e të ardhurave me degete e tatimeve dhe deget e doganave.

I.9.ARDHURA NGA TAKSA E PULLËS GJENDJES CIVILE



BASHKIA VAU DEJËS
Paketa Fiskale 2025

Baza ligjore: Ligji nr. 9975 datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, neni 8. Udhëzimin Nr. 26, datë 04.09.2008 “ Për taksat kombetare”, i ndryshuar

Taksa e pullës është e barabartë me 5 % të shumës së arkëtuar për shërbimin e kryer e cila varet nga kërkesa apo nevoja e qytetarëve për çertifikata.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

Zyra e Gjendjes Civile në rolin e agjentit tatimor është përgjegjëse për mbledhjen e kesaj takse ku 5 % e shumës kalon për llogari të Bashkisë me akt rakordimet përkatëse.

KAPITULLI II. TARIFAT VENDORE

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët: Llojit të shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, Kreu VII, neni 35, i ndryshuar, Ligji Nr. 68/2017, date 27.04.2017 “Per Financat vendore”, kreu III, neni 14,

II.1.TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE

Në programin e tarifave vendore, tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave përbën tarifën kryesore. **Perkufizimi:** Objekt i tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave janë të gjithë subjektet private, fizik e juridik, vendas dhe të huaj të cilët ushtrojnë aktivitet në juridiksionin e Bashkisë Vau Dejës, familjet rezidente në Bashki si dhe ndërmarrjet dhe institucionet.

Mbeshtetur ne ligjin nr. 10563, date 22.09.2019 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” te ndryshuar, ne VKM Nr.319/2018, date 31.5.2018 “Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te mbetjeve”ne Planin Lokal te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve te Ngurta Urbane 2020-2025 te Bashkise Vau dejes, te miratuar me VKB Nr. 62, date 26.10.2020 “Per miratimin e planit lokal te menaxhimit te mbetjeve te ngurta urbane, per vitet 2020-2025”, dhe shprehjes se ligjshmerise nga prefektura Nr. 758/1, date 9.11.2020, te ndryshuar me VKB nr. 79, date 30.10.2023, shprehjen e ligjshmerise nga prefektura me Nr. 720/1, date 14.11.2023, Bashkia ka miratuar tarifat mbeshtetur ne koston e sherbimit.

Katëgoritë, nënkatëgoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së Pastrimit janë të shprehura si më poshtë vijon:

Tabela nr. 9

Tabela përmbledhëse e tarifës së pastrimit sipas kategorive		
Nr.	KATEGORITE	Niveli i tarifës për vitin 2025
II.1.1	Familjet ne Nj.A. Vau-dejes Qender, Bushat, Hajmel	2000



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

II.1.2	Familjet ne Nj.A. Vig-Mnele, dhe Temal	500
II.1.3	OJF	10,000
II.1.4	Ambulant	5.000
II.1.5.	Subjektet me xhiro 0 – 8 milion leke në vit	150/leke/m2 ndertese
II.1.5.1	Profesione te Lira	
II.1.5.1.1	Shërbime laburante, stomotologjike, shërbime farmaceutike.	20,000
II.1.5.1.2	Avokat, Arkitekt, IT, Inxhinier, Elektriçist, Hidraulik, etj.	14,000
II.1.5.2.	Transport për pasagjerë	
II.1.5.2.1	Automjete deri në 9 vende	6,000
II.1.5.2.2	Automjete 10-42 vende	10,000
II.1.5.2.3	Automjete mbi 42 vende	11,000
II.1.5.3	Transport Mallrash	
II.1.5.3.1	Automjete deri në 5 ton	6,000
II.1.5.3.2	Automjete 5-16 ton	10,000
II.1.5.3.3	Automjete mbi 16 ton	11,000
II.1.5.4	Transport me varka	
II.1.5.4.1	Mjete deri ne 10 pasagjere	20,000
II.1.5.4.2	Mjete me mbi 10 pasagjere	50,000
II.1.5.5	Subjekte me veprimtari bujqesore blegtorale	120 leke/m2 ndertese
II.1.6.	Subjekte Juridike të Mëdha me xhiro 8,01 deri ne 200 milion leke	
II.1.6.1	Bar-Restorante, bar-kafe, etj te ngjashme me to	70,000
II.1.6.2	Subjekte tregtim artikuj ndryshem ushqimor dhe industrial	70,000
II.1.6.3	Subjekte shërbimi mekanike, servise, gomisteri etj.	70,000
II.1.6.4	Tregtim karburante me pakice	45,000
II.1.6.5	Tregtim karburanti me shumice	70,000
II.1.6.6	Subjekte prodhimi asfalto-beton, blloqe, tulla, mermer, etj	70,000
II.1.6.7	Subjekte ndërtimi të regjistruar pranë Bashkisë Vau Dejës.	70,000
II.1.6.8	Subjekte me aktivitet punime & përpunime duralumini, metalesh, guri, druri etj.	60,000
II.1.6.9	Subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushen e inerteve	150,000
II.1.6.10	Subjekte dege të shoqerive së huaj	210.000
II.1.6.11	Subjekte shërbimi, agjensi sigurimi, transporti, loto, banka,	50,000
II.1.6.12	Subjekte shërbimi, Wester union	30 000
II.1.6.13	Subjekte tregtare, shërbime telefoni fikse, mobile, internet.	50,000
II.1.6.14	Subjekte të transmetimit të energjisë, OSHE, OST	100 leke/m ² /vit
II.1.6.15	Njësia e prodhimit të gjithë H/C	100 leke/m ² /vit



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

II.1.6.16	Reparti Ushtarak 1010	100 leke/m ² /vit	
II.1.6.17	Subjektet prodhim mishi, peshku, qumështi, stalla derrash, lopesh etj.	70,000	
II.1.6.18	Subjekte prodhuese me veprimtari bujqesor/blegtorale	50,000	
II.1.7.	Subjektet Juridike te Medha me xhiro mbi 200 milion leke		
II.1.7.1	Subjekte sherbimi	70,000	
II.1.7.2	Te tjera	200,000	
II.1.8. Institucionet			
II.1.8.1	Posta Shqiptare, Spitale, Qendra Shëndetsore, Materniteti etj.	20,000	
II.1.9. Subjekte pa seli të përhershme			
II.1.9.1	Subjektet pa ndërtesë si karpentier, etj	12,000	
II.1.9.2	Subjekte me veprimtari agroturizem	5.000	
II.1.9.3	Te tjera	10.000	
II.1.10.Subjekte ndertimi sipas vleres investimit dhe kohezgjatjes se kantier ndertimit (leke/kantier/vit)			
a	Për vlera investimi deri ne 5 000 000 lekë	Lek/kantier/vit	30,000
b	Për vlera investimi 5 000 001 – 10 000 000 lekë	Lek/kantier/vit	50,000
c	Për vlera investimi 10 000 001- 20 000 000 lekë	Lek/kantier/vit	70,000
d	Për vlera investimi 20 000 001 – 30 000 000 lekë	Lek/kantier/vit	75,000
e	Për vlera investimi 30 000 001 – 40 000 000 lekë	Lek/kantier/vit	80,000
f	Për vlera investimi 40 000 001 - 50 000 000 lekë	Lek/kantier/vit	100,000
g	Për vlera investimi 50 000 001 - 100 000 000 lekë	Lek/kantier/vit	150,000
h	Për vlera investimi 100 000 001- 200 000 000 lekë	Lek/kantier/vit	200,000
i	Për vlera ivestimi mbi 200 000 000 lekë	Lek/kantier/vit	500,000

Lehtësi tatimore:

Përfitojne lehtesi tatimore, nga pagesa e tarifës së pastrimit familjare me masen 50 % kategoritë si më poshtë:

- a) Familjet që kanë kryefamiljarin me status "Invalid i punës" sipas ligjit nr 7889 datë 14.12.1994, neni 16.
- b) Familjet që kanë kryefamiljarin me status "Të verbër" sipas ligjit nr. 8098 datë 28.03.1996, neni 4.
- d) Familjet që kanë kryefamiljarin me status "Invalid luftë kunder pushtuesve nazifashistë", sipas ligjit nr. 7663 datë 20.01.1993 neni 9.
- e) Familjet që kanë kryefamiljare "Femer" qe trajtohen me ndihme ekonomike.
- ë) Gra kryefamiljare, viktima te dhunes ne familje, apo viktima trafikimi.



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

f) Subjektet që ushtrojnë me shume se një lloje aktiviteti brenda një ndertese, aktiviteti i 2/3 të perfitojnë lehtësi në masën 50%.

Perjashtime:

- a) Perjashtohen nga tarifa e pastrimit, familjet në Njesia Administrative Shllak, deri në momentin e ofrimit të shërbimit.
- b) Perjashtohen nga tarifa e pastrimit objektet fetare (kisha/xhamia)
- c) Perjashtohen subjektet që perfitojnë projekte nga Zyra e Punës (START-UP) në vitin e parë.
- d) Pershtohen subjekti Zadrime Agrikulture dhe të tjera në varesi të Bashkisë.

Mënyra e njoftimit dhe pagesës:

Për kategorinë “familje” baza e tarifës së pastrimit është regjistri i gjendjes civile të Bashkisë Vau-Dejës. Njoftim detyrim i për këtë kategori të bëhet gjatë gjithë vitit 2025, ndërsa afati për të paguar të jetë brenda datës 31.12.2025.

Për kategorinë “biznese” baza e tarifës së pastrimit të jetë nr. bizneseve sipas regjistratit të QKB. Njoftim detyrim i të bëhet me një kësht të vetëm brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025, ndërsa afati për të paguar të jetë brenda datës 30.06.2025.

Vendi i pagesës së tarifës së pastrimit është pranë çdo banke të nivelit të dytë për llogari të Bashkisë, posta sh.a, dega Hajmel dhe Bushat.

Strukturat përgjegjëse për vijën e tarifës :

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife është sektori i taksave dhe tarifave vendore, pranë Bashkisë Vau-Dejës.

II.2. TARIFA E GJELBËRIMIT

Mbeshtetja ligjore: Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, Kreu V, neni 35, i ndryshuar.

Tarifës së gjelbërimit i nënshtrohen të gjithë personat privatë fizik e juridik, vendas e të huaj, familjet rezidente në bashki si dhe ndërmarrjet dhe institucionet.

Nivelet treguese të tarifës së gjelbërimit janë të shprehura më poshtë për familjaret, biznesin e vogël të madh dhe institucionet.

Detyrimi për pagesën e tarifës së gjelbërimit është vjetor.

Niveli i tarifës së gjelbërimit është si më poshtë:

Tabela nr. 10

Tabela përmbledhëse e tarifës së gjelbërimit sipas kategorive		
Nr.	KATEGORITE	Niveli i tarifës për vitin 2025



BASHKIA VAU DEJËS
Paketa Fiskale 2025

II.2.1	Familjet	200
II.2.2	OJF	2,000
II.2.3	Ambulant	1,000
II.2.4	Subjektet me xhiro 0-8 milion leke në vit	3,000
II.2.5. Profesione te Lira		
II.2.5.1	Shërbime laburante, stomotologjike, shërbime farmaceutike.	4,000
II.2.5.2	Avokat, Arkitekt, IT, Inxhinier, Elektriçist, Hidraulik, etj	3,000
II.2.6. Transport për pasagjerë		
II.2.6.1	Automjete deri në 9 vende	2,000
II.2.6.2	Automjete 10 – 42 vende	3,000
II.2.6.3	Automjete mbi 42 vende	4,000
II.2.7. Transport Mallrash		
II.2.7.1	Automjete deri në 5 ton	2,000
II.2.7.2	Automjete 5- 16 ton	3,000
II.2.7.3	Automjete mbi 16 ton	4,000
II.2.8. Subjekte Juridike të Medha me xhiro 8 – 200 mln leke		
II.2.8.1	Bar-Restorante, bar-kafe, interenet etj te ngjashme me to	4,000
II.2.8.2	Subjekte tregtim artikuj ndryshem ushqimor	4,000
II.2.8.2	Subjekte tregtimi artikuj ndryshem industrial (materiale ndertimi, etj)	4,000
II.2.8.3	Tregtim karburanti me pakicë	4,000
II.2.8.4	Tregtim karburanti me shumice	6,000
II.2.8.5	Subjekte prodhim asfalto-beton, blloqe, tulla, mermer, etj	5,000
II.2.8.6	Subjekte ndërtimi të regjistruar pranë Bashkisë Vau Dejës.	5,000
II.2.8.7	Subjekte me aktivitet punime & përpunime duralumini, metalesh, druri etj.	5,000
II.2.8.8	Subjekte tregti artikuj të ndryshëm.	3,000
II.2.8.9	Subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e inerteve	10,000
II.2.8.10	Subjekte dege të shoqërive të huaja	10,000
II.2.8.11	Subjekte shërbimi, agjensi sigurimi, transporti, loto, banka,	3,000
II.2.9.12	Subjekte shërbimi, Wester union	3,000
II.2.8.13	Subjekte tregtare, shërbime telefoni fikse, mobile, internet.	5,000
II.2.8.14	Subjekte të transmetimit të energjisë, OSSHEE, OST	50,000
II.2.8.15	Njësia e prodhimit H/C Vau Dejes, H/C Koman, H/C Ashtë	50,000
II.2.8.16	Reparti Ushtarak 1010	10,000
II.2.8.17	Subjektet prodhim mishi, peshku, qumështi, stalla derrash, lopesh etj.	5,000
	Subjekte prodhuese me veprimtari bujqësor/blegtorale	3,000



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

II.2.9	Subjektet e medha me xhiro mbi 200 mln leke	10,000
II.2.10. Institucionet		
II.2.10.1	Posta shqiptare, Spitale, Qendra Shendetsore dhe materniteti.	3,000
II.2.11. Subjekte pa seli të përhershme		
II.2.11.1	Subjektet pa ndërtesë si karpentier, etj	3,000
II.2.11.2	Subjekte me veprimtari agroturizem	3,000
II.2.11.3	Te tjera	2,000

Lehtësi tatimore:

Përfitojnë lehtësi tatimore, nga pagesa e tarifës së gjelberimit familjare me masen 50 % kategoritë si më poshtë:

- Familjet që kanë kryefamiljarin me status "Invalid i punës" sipas ligjit nr 7889 datë 14.12.1994, neni 16.
- Familjet që kanë kryefamiljarin me status "Të verbër" sipas ligjit nr. 8098 datë 28.03.1996, neni 4.
- Familjet që kanë kryefamiljarin me status "Invalid luftë kundër pushtuesve nazifashistë", sipas ligjit nr. 7663 datë 20.01.1993 neni 9.
- Familjet që kanë kryefamiljare "Femer" që trajtohen me ndihme ekonomike.

Perjashtime:

- Perjashtohen nga tarifa e gjelberimit, familjet në Njesia Administrative Temal Shllak, Vig-Mnele dhe fshatrat Dush, Karme, Gomsiqe të Nj.A Vau-Dejes, deri në momentin e ofrimit të shërbimit.
- Perjashtohen nga tarifa e gjelberimit objektet fetare (kisha/xhamia).
- Perjashtohen subjektet që përfitojnë projekte nga Zyra e Punës (START-UP) në vitin e parë.
- Pershtohen subjekti Zadrima Agrikulture dhe të tjera në varesi të Bashkisë.

Mënyra e pagesës:

Pagesa e tarifës së gjelbërimit paguhet me një kësht të vetëm, brenda datës 30 qershor 2025, për bizneset dhe brenda datës 31.12.2025, për familjarët.

Vendi i pagesës së tarifës së gjelbrimit është pranë çdo banke të nivelit të dytë për llogari të Bashkisë Vau Dejës, ose dhe nepermjet postes shqiptare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës :

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife është sektori i taksave dhe tarifave vendore, pranë Bashkisë Bashkisë Vau Dejës dhe zyra e taksave në Njesinë Administrative Bushat dhe Hajmel.

II.3. TARIFA PËR NDRIÇIMIN RRUGOR

Tarifa e ndriçimit paguhet nga të gjithë personat privatë fizik e juridik, vendas e të huaj, familjet rezidente në bashki si dhe ndërmarrjet dhe institucionet, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

territorit të Bashkisë Vau Dejës. Tarifa llogaritet duke u mbështetur në koston e shërbimit dhe në zgjerimin e këtij shërbimi në territorin e Bashkisë Vau Dejës.

Mbeshtetja Ligjore: Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, Kreu V, neni 35, i ndryshuar;

Nivelet treguese të tarifës së ndriçimit janë të shprehura më poshtë për familjaret, biznesin e vogël të madh dhe institucionet.

Detyrimi për pagesën e tarifës për ndriçimin rrugor është vjetor.

Tabela nr. 11

Tabela përmbledhëse e tarifës së ndriçimit sipas kategorive		
Nr.	KATEGORITE	Niveli i tarifës për vitin 2025
II.3.1	Familjet	1,000
II.3.2	OJF	5,000
II.3.3	Ambulant	1,000
II.3.4	Subjektet me xhiro 0-8 milion leke në vit	5,000
II.3.5. Profesione të Lira		
II.3.5.1	Shërbime laborante dhe stomatologjike, shërbime farmaceutike	10,000
II.3.5.2	Avokat, Arkitekt, IT, Inxhinier, Elektriciist, Hidraulik, etj	6,000
II.3.6. Transport për pasagjerë		
II.3.6.1	Automjete deri në 9 vende	2,000
II.3.6.2	Automjete 10 – 42 vende	3,000
II.3.6.3	Automjete mbi 42 vende	4,000
II.3.7. Transport Mallrash		
II.3.7.1	Automjete deri në 5 ton	3,000
II.3.7.2	Automjete 5-16 ton	5,000
II.3.7.3	Automjete mbi 16 ton	7,000
II.3.8. Subjekte Juridike të Medha 8 - 200 milion leke		
II.3.8.1	Bar-Restorante, bar-kafe, interenet etj të ngjashme me to	7,000
II.3.8.2	Subjekte tregtim artikuj ndryshëm ushqimor dhe industrial	7,000
II.3.8.3	Subjekte shërbimi mekanike, servise, gomisteri	7,000
II.3.8.4	Tregtim karburanti me pakicë	10,000
II.3.8.5	Tregtim karburanti me shumice	10,000
II.3.8.6	Subjekte prodhim asfalto-beton, blloqe, tulla, mermer, etj	10,000
II.3.8.7	Subjekte ndërtimi të regjistruar pranë Bashkisë Vau Dejës.	10,000
II.3.8.8	Subjekte me aktivitet punime & përpunime duralumini, metalesh, druri etj.	10,000



BASHKIA VAU DEJËS
Paketa Fiskale 2025

II.3.8.9	Subjekte tregti artikuj të ndryshëm.	7,000
II.3.8.10	Subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e inerteve	15,000
II.3.8.11	Subjekte dege të shoqërive të huaja	15,000
II.3.8.12	Subjekte shërbimi, agjensi sigurimi, transporti, loto, banka,	5,000
II.3.8.13	Subjekte shërbimi, Western union	5,000
II.3.8.14	Subjekte tregtare, shërbime telefoni fikse, mobile, internet.	5,000
II.3.8.15	Subjekte të transmetimit të energjisë, OSSHEE, OST	50,000
II.3.8.16	Njësia e prodhimit H/C Vau Dejes, H/C Koman, H/C Ashtë	50,000
II.3.8.17	Reparti Ushtarak 1010	10,000
II.3.8.18	Subjektet prodhim mishi, peshku, qumështi, stalla derrash, lopesh etj.	7,000
	Subjekte prodhuese me veprimtari bujqësor/blegtorale	6,000
II.3.9	Subjektet me xhiro mbi 200 milion leke	50,000
II.3.10. Institucionet		
II.3.10.1	Posta shqiptare, Spitale, Qendra Shëndetsore dhe materniteti.	5,000
II.3.11. Subjekte pa seli të përhershme		
II.3.11.1	Subjektet pa ndërtesë si karpentier, etj	1,000
II.3.11.2	Subjekte me veprimtari agroturizem	5,000
II.3.11.3	Te tjera	2,000

Lehtësi tatimore

Përfitojnë lehtësi tatimore, nga pagesa e tarifës së ndricimit familjare me masën 50 % kategoritë si më poshtë:

- Familjet që kanë kryefamiljarin me status "Invalid i punës" sipas ligjit nr 7889 datë 14.12.1994, neni 16.
- Familjet që kanë kryefamiljarin me status "Të verbër" sipas ligjit nr. 8098 datë 28.03.1996, neni 4.
- Familjet që kanë kryefamiljarin me status "Invalid luftë kundër pushtuesve nazifashistë", sipas ligjit nr. 7663 datë 20.01.1993 neni 9.
- Familjet që kanë kryefamiljare "Femer" që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Perjashtime:

- Perjashtohen nga tarifa e ndricimit, familjet në Njësia Administrative Temal Shllak, Vig-Mnele dhe fshatrat Dush, Karme, Gomsiqe të Nj.A Vau-Dejes, deri në momentin e ofrimit të shërbimit.
- Perjashtohen nga tarifa e ndricimit objektet fetare (kisha/xhamia).
- Perjashtohen subjektet që përfitojnë projekte nga Zyra e Punës (START-UP) në vitin e parë.
- Pershtohen subjekti Zadrime Agrikulture dhe të tjera në varesi të Bashkisë.

Mënyra e pagesës:



BASHKIA VAU-DEJËS
Paketa Fiskale 2025

Pagesa e tarifës së ndriçimit paguhet me një kësht të vetëm brenda dates 30 qershor 2025, per bizneset, dhe brenda date 31.12.2025 per familjaret.

Vendi i pagesës së tarifës së ndriçimit është pranë çdo banke të nivelit të dytë për llogari të Bashkisë Vau Dejës, ose dhe nepermjet postes shqiptare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës :

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife është sektori i taksave dhe tarifave vendore, pranë Bashkisë Vau Dejës.

II.4.TARIFA PËR ZËNIE HAPËSIRE PUBLIKE

Mbeshtetja Ligjore: Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, i ndryshuar, Ligji Nr. 68/2017, date 27.04.2017 “Per financat vendore”, neni 15, si dhe ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, VKM. Nr. 1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, Ligji nr. Nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”

Tarifa për zënien e hapësirave publike paguhet për zënien e hapësirave publike. Kjo tarifë llogaritet si detyrim mujor i subjektit/individit.

Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m², e cila merret në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi, aktivitete, etj.

Kategoritë:

Niveli tarifës së zënies së hapësirës publike është si më poshtë:

Tabele nr. 12

Nr.	Tarifa per zënie hapësire publike	Njësia	Niveli i tarifës për vitin 2025	
			Nj.A Vau-Dejes dhe Bushat	Njesite e tjera
II.4.1	Zenie hapësires ne zonat publike ose para mjediseve te biznesit, per qëllime biznesi, perfshire ketu tavolinat jashte per bare dhe restorante	lek/m ² /m	100	50
II.4.2	Zenie hapësire publike prane brigjeve ujore per biznes dhe qëllime tjera.	lek/m ² /m	80	40
II.4.3	Zenie hapësire publike per mbajtjen e materialeve te ndertimit.	lek/m ² /m	100	50
II.4.4	Zenie e hapësires publike per perdorimin e tabelave dhe reklamave	lek/m ² /m	60	30
II.4.5	Zenie hapësire publike per vendosje tendash	Lek/m ² /dite	50	25
II.4.6	Zënia e hapësirës publike ditore për qëllime			



BASHKIA VAU DEJËS
Paketa Fiskale 2025

	biznesi: ekspozim – promocion i produkteve, i shërbimeve, aktivitete tregtare, etj	Lek/m2/dite	50	25
--	--	-------------	----	----

Përfashtime: Përfashtohen nga tarifa e zënies së hapësirës publike ditore, subjektet që zhvillojnë aktivitete në partneritet me Bashkinë Vau-dejes.

Detyrimi për pagesën: Drejtoria e Planifikimit Territorit dhe Investimeve Publike, harton planin, për zënien e hapësirës publike në të gjithë territorin e Bashkisë Vau-dejes, ku përcakton zonën, sipërfaqen, periudhën dhe qëllimin e lejuar të shfrytëzimit, dhe rregulloren perkatese. Sektori Aseteve, bazuar në planin e hartuar, nga DPTIP prane Bashkise, nënshkruan kontratat me subjektet që kanë paraqitur kërkesën për marrjen me qera të hapësirës publike, dhe ja dergon sektorit të taksave dhe tarifave vendore, i cili ndjek procedurat e faturimit dhe shlyerjes së detyrimit.

Derdhja e të ardhurave për këtë tarifë në favor të bashkisë, bëhet sipas kushteve të percaktuara në kontratën me paleve.

